



MINISTRIA E KULTURËS, RINISË DHE SPORTIT

MINISTARSTVO KULTURE, OMLADINE I SPORTA/ MINISTRY OF CULTURE YOUTH AND SPORTS

DEPARTAMENTI I FINANCAVE DHE SHËRBIMEVE TË PËRGJITHSHME/DEPARTMENT OF FINANCES AND

GENERAL SERVICES/DEPARTMAN I FINASIJA I GENERALNIH USLUGA

**DIVIZIONI PËR BURIME NJËREZORE/ DIVIZION OF HUMAN RESOURCES/ DIVIZIJA LJUDSKIH IZVORA**

Bazuar në Ligjin për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës nr. 03/L-149 dhe Rregulloren nr. 02/2010 për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, Rregulloren Nr. 21/2012 për Avancim në Karrierë të Nëpunësve Civil, Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit shpall:

**KONKURS**

**Institucioni:** Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit

**Titulli i punës:** Drejtor ne Departamentin e Kulturës

**Kategoria funksionale / 10 Koeficienti:**

**Numri i referencës:** 13 / 2018

**I përgjegjet:** Sekretarit të Përgjithshëm

**Vendi:** Prishtinë

**Detyrat dhe përgjegjësitë:** Nën mbikëqyrjen e Sekretarit të Përgjithshëm

**Detyrat kryesore:**

1. Udhëheq dhe cakton objektivat e departamentit në përputhje me strategjinë dhe objektivat e institucionit dhe dizajnon planet vjetore të punës të detajuara për ti përmbushur këto objektiva ;
2. Menaxhon stafin dhe buxhetin e departamentit dhe organizon punën përmes ndarjes së detyrave tek të varurit, ofron udhëzime dhe monitoron punën e stafit për të ofruar produkte dhe shërbime cilësore që janë relevante me funksionet e departamentit;
3. Analizon dhe vlerëson proceset dhe procedurat e brendshme dhe rekomandon ndryshime/përmirësime me qëllim të rritjes së efikasitetit;
4. Zhvillon dhe mbikëqyre zbatimin e politikave dhe procedurave dhe ofrimin e shërbimeve në Departamentin e Kulturës;
5. Drejton funksionimin dhe administrimin e sistemit në Departamentin e Kulturës;
6. Ka përgjegjësi të gjëra dhe të shumëllojshme, përfshirë zhvillimin dhe mbajtjen e kontakteve të niveleve të larta me institucionet qeveritare dhe organizatat tjera;
7. Siguron ofrimin e shërbimeve të fushës së Kulturës dhe arkivimin e dokumenteve dhe shërbimeve tjera për ministrinë.
8. Bën vlerësim të rregullt të stafit nën mbikëqyrje të tij dhe përkrah zhvillimin e tyre përmes trajnimeve për të siguruar kryerjen e detyrave të tyre në nivel me standardet e kërkuara.

**Procedura e konkurrimit:** Konkurrimi është i hapur për të gjithë shërbyesit civil- 8 ditë.

**Shkollimi i kërkuar, përvoja, aftësitë dhe karakteristikat personale:**

- Njohuri dhe përvojë substanciale në fushën e Kulturës;
- Shkathtësi të lartë në menaxhim, organizim, caktimit të objektivave dhe planifikim;
- Njohuri të mira për mbikëqyrje efektive të punës profesionale të kryer nga vartësit;
- Qasje fleksibile ndaj organizimit dhe mbikëqyrjes së punës, përfshirë zgjedhjen e problemeve;
- Shkathtësi kompjuterike të aplikacioneve të programeve (Word, Excel, Power Point, Access);
- Diplomë universitare, Shkencat Soqerore (Diplomë nga fusha e Kultures, Artit, Muzikës).
- 7 vite përvojë pune profesionale, përfshirë se paku 4 vite në pozitë drejtuese;

**Kushtet e pjesëmarrjes në konkurs:** Të drejtë aplikimi kanë të gjithë shërbyesit civil brenda MKRS-së.

**Data e mbylljes së konkurrimit: 04.04.2018**

**Paraqitja e kërkesave:** Aplikacioni merret dhe dorëzohet në zyrën 27 të Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit, Sheshi "Nëna Terezë" nr. 44. Për informata shtesë kontaktoni në numrin 038211-449 ( apo në ueb-faqen <http://www.mkrs-ks.org/>). „